REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 28.02.2025 Prot.33 (tridhjetëetre)

Protokoll nr. 33

I mbajtur sot më datë 28.02.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.01.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2025";
5.P-V "Për miratimin e bursave për nxënsit e arsimit të mesëm nga buxheti i bashkisë për vitin shkollor 2024-2025";
6.P-V "Për miratimin e Raportit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024";
7-P-V "Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta";
8-P-V "Për transferimin e materialeve të magazinës së Bashkisë Maliq, Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse";
9.P-V "Për marrjen e ambienteve me qira, për Pensionistët në fshatin Sheqeras Njësia Administrative Vreshtas";
10.P-V " Për miratimin e listës të kullotave, të gatshme për kullotje dhe kositje për sezonin 2025 dhe miratimin e kontratës tip të dhënies me qira për kullotje";
11.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Spiro Roko banues në bllokun nr.4 Maliq, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
12.P-V "Për dërgimin për bashkëfimincim të projektit *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizura"* për vitin 2025";
13.Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë keshillit bashkiak *"Mbi heqjen e mandatit të znj. Rudina Bregu"*, pas kërkesës për dorëheqje.
14.Informacion nga Zyra e Integrimit Europian dhe Koordinimit të Ndihmës të Huaj, lidhur me çështje të kërkuara nga Këshilli Bashkiak.
15.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Marainathi Avrami; Idlir Limllari; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Xhuana Hoxhallari; Ilia Xhuti; Klea Baçi; Eglantina Balli; Neresida Shindo; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Dalina Krekas; Faslli Zholi; Almir Elezi; 26(njëzetëegjashtë) këshilltarë.

Mungesa: Rovena Terolli; Plator Çollaku; Ornildi Demollari; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; 5 (pesë)këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit:z.Ledion Mullalli; Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota:z.Klaresn Brako.

Enida Avdolli: Mirëdita të gjithve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, jmei mbledhur në mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, me rendin e ditës me të cilin jeni njohur më pare.Së pari verfikojmë korumin, 24 Këshilltarë (shkon në 26) në sallë, korumi realizohet.Kalojmë te rendi i ditës, te rendi i ditës, kemi disa P-V shtesë, te pika e dhënies të ndihmës finanaciare për rënie zjarri, kemi shtesa dh dy familje të tjera banuese në fshatin Korritë NJ.A Vreshtas.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju kërkoj ndjesë, mund të largohem për pak minuta, kam një takim?

Enida Avdolli: Dakord.Te pika e rënies të zjarrit, kemi shtaur dhe dy familje të tjera dhe gjithashtu kemi dhe tre P-V, një P-V "Për shpenzime varrimi", një P-V tjetër, "Për bashkëfimacimin e marrveshjes së përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut", për moshën e tretë dhe P-V për përdorimin e fondit "Për mbrojtjen civile nga fondi i buxhetit të shtetit".Nëse jeni dakord ta kalojmë rendin e ditës me shtesat?

Yllson Ibrahimllari:Në lidhje me rregulloren, krahësmisht me atë që kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar, sepse këtu kemi pesëmbëdhjetë pika, 3-4 mund ti bëni një pikë, ndërkohë vijnë dhe tre të tjera.Regullorja shpehet qartë, nëse nuk ka emergjencë, jo mëshumë se një numur të caktuar pikash, sespe po bëhet e rrugës, sikur jemi të gjithë në gjumë.

Enida Avdolli:Nëse dy shtesat për familjet që kanë patur rënie zjarri, do i përfshinim te njëra pikë, sepse ne e kemi si pikë, mund të quhet një P-V dhe duke shtuar tre pika të tjera, në total sa shkon Gerti? Duke hequr dhe pikat e para, korumi etj.

Yllson Ibrahimllari:Nëse janë thjeshtt procedurë? Mos i vini si pika, ti lemë në një pikë të vetmem hapja, deklarimi dhe miratimi, ti grupojmë dhe nuk bëjmë debat.

Enida Avdolli:Në total bashkë me shtesat shkojnë pesëmbëdhjetë pika neto, jeni dakord ta miratojmë rendin e ditës?

Lulëzim Hoxhaj: Kam edhe diçka unë, për Nildin uroj mos ketë diçka shëndetësore sot, nuk na i tha arsyen pse mungon.Për drejtimin e senacës, kur mungon Kryetari e drejton një nga Nën/Kreytarët.

Yllson Ibrahimllari:E drejton një nga Nën/Kreytarët e zgjedhur nga Pozita, lexoni rregulloren e këshillit Bashkiak.

Enida Avdolli: Atëhere vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 26vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet rendi i ditës, vazhdojmë me pikëne dytë, po ju njoh me vendimet e mbledhjes së kalaur, 8 (tetë) janë me karkter (normativ) dhe 7 (shtatë) me karkter individual ose kolektiv.

Enida Avdolli: Ju ftoj të kalojmë në votim proceverablin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord me proceverabalin? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet proceverabali, faleminderit!Kalojmë te P-V nr.4, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2025";Kemi ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë?
Yllson Ibrahimllari: Para se të dëgjojmë Komisionin te kjo pikë jemi në vazhdimësi e një procedure që vazhdon të mos ndiqet.Në këshilli kemi rënë dakord që listat e Ndihmës Ekonomike do të publikohen në NJ.A dhe do të shpallen, që banorët vetë të shikojnë, të hiqet ajo hija e abuzimit të banoreve prezent në zonë, sepse Ndihma Ekonomike, nuk jepet as me dekalaratë noteriale as me përfaqësi juridike.Ju faleminderit! Duke qenë se është një zonë ecila njeh dhe emigracionin sezonal krijon gjithmonë probleme në këtë pikë, e kemi diskutar, jemi përballë pozitës, ku grupi i opozitës ka bërë kallzim penal për këtë çështje, është në Prokurori çështja, besoj se këtë herë do e monitrojmë, do shkojmë në NJ.A dhe do fotografojmë ne si Këshilltarë për të bërë publike listat e Ndihmave Ekonomike. Faleminderit!

Faslli Zholi:Këtu te Ndihmat Eknomike, e diskutova dhe në mbledhje të Komisionit, këtu ne na vjen vetëm lista e fondit 6%, do jetë në nderin e këtij Këshilli që lisat e Ndihmës Eknomike të bëhen publike, jo vetëm 6%, por ka familje që ka diferenca në marrjen e pagesës, ne nuk i dimë kush janë këto familje që janë në nevojë a është e mundur që këto lista të bëhen publike?

Enida Avdolli: Znj.Ermanda kemi ndonjë koment në lidhje me këtë?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje! Sipas udhëzimit tuaj dhe gjithashtu sipas ligjit që na i përcakton ne duhet ti afishojmë listat pranë çdo NJ.A Administrative, lista afishohen pranë çdo NJ.A, në të shtata NJ.A Administrative të bashkisë Maliq, janë listat e afishuara, unë mund tja u vërtetoj dhe me foto që janë listat të afishuara, atje është transparenca se kush e përifton dhe kush jo Ndihmën Ekonomike.

Faslli Zholi: Unë po thoja që këto lista të afishohen dhe në fshatrat me më zë të bashkisë, e dyta nuk janë ato lista që unë po has për qyetatarët, janë vetëm të fondit 6% .Këshilli kërkon të dijë cilat janë familjet në rrezik dhe marrin gjithë këto Ndihma Ekonomike.Faleminderit!

Enida Avdolli: Kemi diçka tjetër? Apo do e kalojmë në votim?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Në NJ.A afishohet lista e përiftuesve nga sistemi i Ndihmës Ekonomike, janë familje të përzgjedhura nga sistemi me një procedurë të caktuar, të miratuar nga Ministria, gjithashtu kemi dhe VKM të posaçme e cila përcakton masën e përfimit për çdo individ të familjes sipas kitereve të përcaktuara po nga këto VKM, bëhet fjalë për listën e madhe me 1800 përiftues.

Faslli Zholi:Është sekret kjo listë me 1800 përiftues, që mos e dijnë Këshilltarët?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Nuk është në rregullore të miratohet në Këshill.Nëse do kërkohet një informacion, patjetër që do ju vijë.

Faslli Zholi: Ne nuk jemi për të mos përfituar familjet, por kemi një përpalsje të madhe me qyetatarët, kjo mabse nga gabimet ose diçka tjetër.Shkojmë bëjmë dëgjesa dhe do e shikoni, ka makinë dhe merre Ndihmë.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Këto janë specifikime të vendosura në ligj, që një familje që të aplikojë për Ndihmë Ekonomike dhe ka punësim dhe një mjet në pronësi mund të aplikojë .

Faslli Zholi: Unë jam për të marrin Ndihmë Ekonomike, vetëm ato familje që ju takon sipas kritereve, të pastrohet lista.Ju falemiderit!

Pranvera Begolli: Kur ne miratonim në total të gjitha Ndihmat Eknomike, lista na vihej në dispozicion dhe atje kishte vend për diskutim, përderi sa lista e Ndihmës Ekonomike miratohet nga Ministria përkatse ne mund të amrrim thjesht një informacion, ne nuk kemi të drejtë ligjore që ajo listë të na paraqitet, ne të drejtën ligjore kemi vetëm për lsitën 6%.Kush është i interesaur të shkojë te NJ.A ku afishohen listat.Mos e vazhdjmë këtë temë, kjo nuk është pjesë e jona.

Petrit Kupe: Do doja nga opozita, të flitet konkretisht, jo të bëjmë zhurmë, për listat pa emra konkretë, në qoftë se flasim me emra konkretë, atëherë kemi të drejtë të përballemi me ata që miratojnë këto lista, listat e Ndihmës Ekonomike miratohen nga sistemi dhe nuk kalojnë në Këshilli, por përsëri nëse keni informacion mund ta pasqyroni, ndërsa lsitat e fondit 6%

miratohen nga Këshilli, nëse dhe këtu keni diçka, jemi dakord që dhe ne tju mbështetim për ata që kanë abuzuar, por për të bërë zhurmë, që ne ngritëm problemin dhe nuk mendoj që lsitat e Ndihmës Ekonomike kanë të bëjnë me politkën, ato janë kritere që miratohen nga Minsitria përkatse.Kalojmë në miratim dhe mos bëjmë zhurmë.

Faslli Zholi:Të nderuar Këshilltarë, ne nuk po bëjmë zhurmë, Ministria miraton buxhetin në lekë dhe pastaj vendosin kriteret kush e përfiton dhe pastaj vendosen emrat, ne nuk po bëjmë zhurmë për fushatë, por ne po bëjmë zhurmë se po ballafqaohemi me qytetarët, kmei dhe raste konkrete, do jua u listoj dhe këtë.

Neresida Shindo:Përshëndetje të gjithve! Faslli duhet të bëhemi pak më racionalë, për sa i përket Ndihmës nga fondi 6% jemi dakord dhe me rregulloren që afishohen listat në çdo NJ.A, sepse ne si Këshill miratojmë vetëm fondin 6%, kemi të drejtë të dimë dhe sa familje trajtohen me Ndihmë Ekonomike nga sistemi dhe nëse do kemi emra konkretë, patjetër do i adresojmë nëzyrën përaktse për të marrë informacion dhe nuk është nevoja për kaq ndërhyrje medoj unë.Faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit! Po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e kuptoj sot dhe në mbledhje të tjera, harxhim kohe që merreni me disa gjëra, që nuk merremi as ne si Bashki, po dhe Këshilli jo.Ka një sistem të Ndihmës Ekonomike të miratuar nga Banka Botrore, ku çdo person ka të drejtë të aplikojë, ne mund të flasim nëse të takon ose jo Ndihma, po të kaloj sistemi.Nëse dikush ka falleifikuar një dokument dhe e hedh në sistem, ju mund ta denonconi, por nuk jem ne ata që i hqeim nga sisitemi, ne kemi të drejtë ta sjellim listën, ta publikojmë në çdo NJ.A, secili prej jush ka të drejtë të thotë që dikush ka falleifikuar një dokument, nuk është punë por në fakt është në punë, ka institucione të tjera që i kontrollojnë, Shërbimi Social Shtetëror.Unë si Kryetar Bashkie nuk jam marrë ndonjëherë, më parë, jo tani që bashkia është shumë e madhe, asnjëhere nuk jam marrë ma familje të Ndihmës Ekonomike, ne a kemi mundësi ti minimizojmë, ata kanë një Ndihmë, që e jep sistemi, e paguan shteti, që duhet kontroll patjetër, duhet të evidendohen dhe ngs zyrat tona dhe, Shërbimi Social Shtetëror, që sa të vërteta janë ato që përfitojnë, me sa di është hequr një numur i madh familjesh, i ka hequr Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, nga evidentimi që ka bërë ne vend, ky është një proces i kalon nga njëra etapë te tjetra.Për familjet e fondit 6%, janë ata që nuk kanë plotësuar pikët, janë me emër dhe mbiemër.Unë mendoj që Këshilli, patjetëre ka të drejtë të informohet, të njihet, të kërkojë llogari, të thotë pse nuk afishohen listat, ka të drejtë të kontrollojë të ngrejë një Komision, të thotë, do shkoj te zyra të shoh dosjet, çdo qytetar e ka këtë të drejtë, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit.Shumë faleminderit! E pashë të arsyeshme të ndërhyja dhe pse nuk isha që në fillim.

Enida Avdolli: Faleminderit Kryetar! E kalojmë në votim pikën 4?

Kush është dakord me Ndihmën Ekonomike? 26 vota pro.

Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet faleminderit!Kalojmë te P-V nr.5, P-V "Për miratimin e bursave për nxënsit e arsimit të mesëm nga buxheti i bashkisë për vitin shkollor 2024-2025"; Kemi ndonjë pyetje apo diskutim?
Yllson Ibrahimllari: Te kjo lista e bursave, dua të ngre dhe një shqetësim për nxënsit e Strelcës dhe Mesmalit, këtu kemi dhe Këshilltarin tjetër që është nga Strelca, për një numur fëmijësh të Strelcës dhe Mesmalit që ndjekin shkollën në Lozhan, nëse do ishte e mundur të gjejmë mekanizmat dhe ju si Komision këtu dhe ne si Këshilli, që atyre nxënsve të paktën tju paguhet transporti, janë fëmijë që familjet e tyre janë vërtet në nevojë dhe rrezikohen mylljet e shkollave në fshatrat respektivë.Ju faleminderit!
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E kemi diskutar dhe vitin e kaluar këtë problem, nuk kemi patur ndonjë diskutim në parim, ndoshta duhet të diskutojmë dhe çfarë detyrime ka Zyra Arsimore Vendore, bazuar në VKM , nëse nuk ka klauzolë ligjore dhe ne na jept mundësia që me fondet tona mund ta kryjmë këtë shërbim do isha dakord që të pakëtën ktyre fëmijve tju japim një mundësi për sakrificën që bëjnë, nëse është mundësia ne do e gjejmë patejtër modalitetin ligjor, që tju japim një pagesë sipas VKM-së që mund të jetë, por duhet para nga ana jurdike, nga Dr.Jurdike. Dr.Financës të rakordojnë me Zyrën Arsimore Vendore, për të parë a gjejmë dot një klauzolë, nuk besoj se numri i fëmijve është shumë i madh dhe ne të mbulojmë një përqindje të caktuar, e kemi disktuar dhe një vit më parë dhe kemi rënë dakord në aprim dhe me sa di ndoshta kemi marrë dhe një vendim Këshilli.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Të sqaroj diçka Kryetar, ata nxënës që kanë aplikar nga NJ.A Gorë, nga shkolla e Lozhanit kanë përfituar katër nxënës nga bursat që kemi marrë nga Ministria e Arsimit, ata e kanë përfitar në fazën e parë, ndërsa tani jemi për nxënist që përfitojnë nga fondet e bashkisë.

Yllson Ibrahimllari: Nuk po flasim për bursë, por për shpenzimet e transportit të furgonit që ata fëmijë paguejnë dy herë në ditë, nëse nuk e bëni ju, e bëj unë privatisht, më jepni listën.Faleminderit!

Gentiana Drabo:të sqaroj diçka, sipas VKM-së Zyrën Arsimore Vendore me fondet e Minsitrisë mbulon transportin për nxënist e arsimit bazë, nga klasa e 1-9, atje ku nuk ka shkollë në qendërn e banimit dhe është i detyruar ta marrë shërbimin larg institucionit sipa km të caktuara, ndërsa për nxënsit e Arsimit të mesëm nuk e ka këtë kopmetencë, ne kemi bashkëpunuar me bashkinë për këtë që diskutuam dhe kjo bursa që jep bashkia për të arsye jepet dhe për të mbuluar transportin, atë që diskutoj dhe Ermanda, që për të mbular dhe pjesën e transportit, ashtu si kemi dhënë bursa dhe për bursa dhe për nxënsit e shkollave të Mesme që udhëtojnë nga Maliqi apo fshatrat e bashkisë drejt shkollave profesionale në Korçë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Këtu kemi nxënës të shkollës të Maliqit të Pirgut te kjo listë, ajo çfarë unë dua të kuptoj nga Ermanda është sa nxënës ka Strelaca apo Mesmali që kanë

përfituar bursë? Apo sa vijnë në shkollën e Lozhanit për të vazhduar arsimin e mesëm dhe a përitfojnë këtë anga këto pagesa, të fazës të parë apo të dytë?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Në djeninë time janë shtatë nxënës që shkojnë nga Strelca në shkollë e Mesme në Lozhan dhe katër nga ata që kanë aplikuar janë përfitues të bursës nga fondet e Ministrisë, ndërsa të tjerët nuk kanë aplikuar për të përfituar bursë, ndërsa dhe një nxënës është në skemën e ekselenxës, duke qenë me mesatare 10 (dhjetë), e kemi përfshirë te skema e ekselenxës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Duke marrë dhe shqetësimin e Këshilltarve, do kërkoja një informacion në mbledhjen e rradhës sa nxënës janë? Sa e përfitojnë?Çfarë mund të bëjmë që tja u kompesojmë dië që tja u kompesojmë diçka nga transporti për këtë qëllim.Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, ajo që thotë Drejtoresha e Arsimit, apo ajo që themi në përgjithësi është një skemë kombëtare që na vjen ne nga Ministria e Arsimit, unë besoj që ky Këshill Bashkiak dhe këtë nënkupton dhe qeverisja vendore.Sa jemi këtu të sjellim shqetësimin, jemi në gjendje ta marrim dhe një vendim ashtu si kemi marrë dhe vendime të tjera, përderi sa nuk është jashtë ligjit, unë nuk kam disktuar asnjëherë se sa shpenzime varrimi vijnë se sa shpi janë djegur, nuk e kam ngritur asnjëherë dorën kundra.

Petrit Kupe: Jemi te pika 2, të miratojë trajtimin me bursa të plota me fondet e bashkisë për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm për nxënsit e listës.Sa është vlera e kësaj burse? Për pikën 1 përmendet, për nxënsit ekselentë., për pikën 2 jo.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Pika 2, është bazuar në VKM-në 666 Për përcaktimin e kuotave dhe masës të përfitmit për bursa, 330 lekë në ditë.

Petrit Kupe: Duhet ta shkruash këtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Petriti ka të drejtë, duhet shkuar masa e përfitmit.

Faslli Zholi: Ne u mblodhëm si Komision i Arsimit dhe i pamë këto, është një kanaqësi, kur na u raportua që fëmijët janë me rezualtate shumë të mira, një vërretje që kisha unë në Komision, të pajisen me një vertetim nxënsit ekselentë, që dhe ne të dimë që janë vërtet me dukumenta.Jam plotësisht dakord me këta fëmijë, kështu dhe motivohen.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet faleminderit!Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Raportit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024"; Kemi ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë?

Petrit Kupe: Ne si Komision i kemi parë tëgjitha pikat dhe pikën që u shtua sot, e trajtuam sot bashkë me Kryetarin, nuk kemi ndonjë gjë të veçantë, bëhet fjalë Për miratimin e Raportit të III-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024"; Për ne konsiderohet një raport pozitiv, për dy arsye, pavarsisht se nuk janë realizuar të ardhurat që këte ne konstatuam, të ardhurat e vitit 2024, janë 7% më të larta se viti 2023, ky është një tregues pozitiv, njëkohësisht treguesi i shpenzimeve u realizua në masën 95.7 %, që për ne është normale mbasi gjatë vitit ka dhe aryse të cilat, nuk e realizojnë 100% .Ky raport të miratohet.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet faleminderit!Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës, P-V "Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta";Kemi ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë?
Petrit Kupe: Dhe këtë P-V, e shqyrtuam dhe e miratuam, të shtohen dhe P-V e tjera për rënie zjarri , arsyeja është mos vonohet ndihma për këto familje, që janë dëmtuar, ndoshta mund ta sshtonim dhe në mbledhjen e ardhshme, por nuk na prish punë sepese është një ndihmë që duhet dhënë menjëherë, ajo tregon dhe përgjegjshmërinë e Administratës dhe të Këshillit, për të ndihmuar këto familje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:P-V që po diskutoni ka të bëjë me riparimin e një ure në zonën e Moglicës, me një vlerë 1.2 milon lekë, është një investim që nuk e kemi realizuar dot në vitin 2024, për mungesë ofertuesish, kjo dhe për shkat të largësisë të Moglicës, ne e kem detyrim për ta rifutur në buxhet me fondet e Emergjencave Civile për ta realziuar se më parë, pasi janë fshatra me pak banorë, e kemi detyrim për ti siguruar transport dhe lëvizje sa më të lehtë të këmbësorve por dhe të mjeteve, meqënse e morra fjalën, fondet janë të Mbrojtjes Civle dhe ne jemi në të njëjtën linjë, kemi futur dhe një P-V ditën e sotme,ja u kemi dhënë Këshilltarve dhe besoj se keni rënë dakord, është fondi që nga është akorduar nga Ministria e Mbrojtjes për Emergjencat Civile, kap një vlerë 7.491.023 lekë, e kemi ndarë në dy momente edhe sipas VKM-së një fond 3.491.023 lekë janë shpezime për mbrojtjen dhe reabilitim të objekteve të ndryshme ndërtimore dhe nemendojmë që këtë ta bëjmë hap pas hapi për ndërtime të cilat mund të kenë rrezik shembje për banesa individuale, banesa kolektive e kemi zbatuar dhe vitet e tjera na ka dhënë shumë rezultat, kemi ndërhyrë në rabilitim të çative të pallateve dhe momenti i dytë ka të bëjë me fondin 4 milon lekë të reja, të cilin ne e palnifikojmë dhe Këshilli e miraton rast pas rasti për të gjitha rastet e rënies të zjarrit gjatë vitit buxhetor për shtëpi të ndryshme në të gjithë territorin e bashkisë.

Enida Avdolli: Faleminderit Kryetar!Po.

Lulëzim Hoxhaj:Përveç fondit për Mbrojtjen Civile me të cilin jam dakord me këtë shifër, unë mendoj që Bashkia duhet të paraprijë me projekte sepse në shkallë kombëtare ka rreth 10 milardë lekë për Mbrojtjen Civile që do shpërndahen Bashkive, por kësaj duhet ti bëhet parapritë me projekte.Në rast se ka projkete si kjo ura, besoj se fitohen goxha fonde.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për informacion të Këshillit ne kemi aplikuar në dy projekte, një projekt për blerje mjetesh për Emergjencat Civile, blerjen e një Auto-Boti për ujrat e zeza dhe ujrat e tjera të cilat janë shumë të domozdoshme në teritorin tonë, të cilat janë nën nivele dhe përmbyten dhe kanë nevojë për largimin e ujrave të zeza, kemi disa fshatra që i kemi me gropa septike.Blerjen dhe të një Borëpastruese, pasi kështu është dhe kërkesa për aplikim që ka bërë Agjencia Kombëtare e Mbrojtejs Civile dhe projekti i dytë ka të bëjë me reabilitimin e digës të rezervuarit të Kolanecit, cili është një projket i mirëfilltë kemi aplikuar të shpresojmë të jemi shpallur fitues.

Enida Avdolli: Kemi koment tjetër?

Yllson Ibrahimllari: Jo koment, ndërhyrje.Për sa i përket riparimit të urës, për kë urë bëhet fjalë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për urën e Moglicës?

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, është bërë studimi gjeologjik? Se ajo urë ka një mangësi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ura e Dusharit ashtu si mund ta dini dhe ju, është një urë vërtet problematike për vetë gjeologjinë e tokës, ne kemi çuar specialistë gjeologë dhe nga Ministria Mbrojtjes, të cilët nuk po i japin një zgjidhje, e kmei të lirohet i gjithë Baseni, pastaj të shojim se çfarë mund të bëjmë në atë pjesë, po mundohemi ta mbajmë në kontroll, rast pas rasti që këmbësorët dhe mjetet mund të kalojnë, por është një situatë e vështirë.

Yllson Ibrahimllari: Faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit! Jeni dakord që ti kalojmë të dy P-V "Për përdorim fondi për mbrojtjen civile"?

Yllson Ibrahimllari: Kisha diçka për pikën 8

Enida Avdolli: Jemi te pika 7 akoma dhe shtesën që keni marrë tani.

Yllson Ibrahimllari: Shtesën që kemi marrë tani, për rezervuarin e Këmbëthekrit që po fliste Kryetari?

Enida Avdolli: Faleminderit! I kalojmë në votim të dy P-V?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohen faleminderit!Kalojmë te pika nr.8 e rendit të ditës, P-V "Për transferimin e materialeve të magazinës së Bashkisë Maliq, Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse";

Petrit Kupe:Bëhet fjalë për zbatimin e vendimt të krijimit të Njësisë të veçnatë në bashkinë e Maliqit, që është miratuar në strukturën e vitit 2025 dhe tani ka ardhur momenti që me VKB të kalojë inventari pranë kësaj Njësie.Kjo është një procedurë që duhet bërë e cila do të kalojë menjëherë mbasi, kjo Njësi duhet fillojë punë menjëherë, pasi do kohë për përgatitjen e materialeve, për procedurat e prokurimi, kështu që jmei dakord të kalojë me VKB inventari pranë Agjencisë.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 8?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet faleminderit!Kalojmë te pika nr.9 e rendit të ditës, P-V "Për marrjen e ambienteve me qira, për Pensionistët në fshatin Sheqeras Njësia Administrative Vreshtas";
Petrit Kupe: Dhe këtë P-V, e shqyrtuam, është një P-V si ato raste kur bashki ju vjen në ndihmë moshës së tretë, në fshatin Sheqeras nuk ka, pasi të miratohet ky P-V, do të kryhen të gjitha procedurat e ofertave dhe të përcaktohet objekti që do ju vijë në ndihmë këtyre pensionisteve.
Floreta Zaçe:Për sa i përket problemit për mbjentin me qira në fshatin Sheqeras, unë mendoj të ketë dhe në Pojan një ambjent për pensionistët, duke ditur që komuniteti është më madh se fshatrat e tjerë.
Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 9?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohe pika 9 faleminderit!Kalojmë te pika nr.10 e rendit të ditës, .P-V "Për miratimin e listës të kullotave, të gatshme për kullotje dhe kositje për sezonin 2025 dhe miratimin e kontratës tip të dhënies me qira për kullotje";
Almir Elezi: Unë Kryetar me këtë P-V nuk jam dakord, sepse mendoj se kjo është në dëm të fermereve që shfrytëzojnë këto kullota, kjo mund ti japi mundësi një fermeri nga një bashki tjetër, të vijë të marrë kullota te ne dhe e kam ngritur dhe më parë për kullotat që janë zaptuar, nuk shoh të jetë marrë ndonjë masë për ti liurar këto toka.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shumë faleminderit! Në fakt ne e kemi detyrim ligjor, por dhe detyrim për të krijuar të ardhura për bashkinë dhe një nga to është dhe ardhura nga kullota.Jemi shumë dakord dhe atë kemi bërë në Paketë Fiskale, ata që janë blektorë të bashkisë Maliq, të kenë një tarifë të diferencuar nga ata që vijnë nga jashtë dhe detyrimin tjetër që ti marrin ata që janë të vendit në atë zonë, në momentin që dikush nuk e merr, atëherë ne duhet të krijojmë të ardhura për institucionin dhe jemi të hapur për këtë punë, që për çdo rast tja japim

atyre në fillim, me tarifë të diferencuar, por të paguajnë një kuotë, sepse e mirëmbajnë dhe nuk e shpërdorojnë.Në momentin e dytë, ke shumë të drejtë dhe ne duhet të marrim patjetër masa për lirimin e gjitha hapësirave, jo vetëm Podgorie por kudo, ajo ti shërbejë gjithë komuniteti ose ata që duan ti marrin me qira.

Almir Elezi: Doja të thoja dhe diçka, fermerët sa po vijnë dhe po reduktohen, fitimi nuk është aq i madh sa të paguajnë dhe kullota, ata dhe me kullotat që janë pa pagesë dhe numri i krereve ka rënë.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota:z.Klaresn Brako: Kjo është thjeshtë një procedurë ligjore, që ne duhet të zbatojmë urdhrin e Ministrit, për sa i përket fermereve, ne kemi shumë kullota, aq sa ata nuk intresohen fare, nuk po i japim dot me qira.Falemiderit! '

Enida Avdolli: Faleminderit!Po z.Serever.

Server Xhuti: Unë jam dakord të jepen kullotat, por duhet të shoqërohen me hartë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne kemi një projekt të realizuar nga Banka Botrore, me numr pasurie me hartë, jemi ndër bashkitë e vetme që kanë një plan të miratuar dhe të rregjistruar në Hipotekë dhe ne kur i japim me qira, i japi me certefikatë, me hartë me të gjitha që mos krijojmë konflikte.Ajo që unë jam i gatshëm të diskutoj, është tarifa, për të shtuar më shumë fermerë, të marin sipërfaqe etj.Por e mira është të ketë një tarifë minimale dhe të gjithë të jenë të përgjegjëshëm, sesa të bëhet rrëmujë.

Enida Avdolli: Faleminderit!Po.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem.Këtu do doja të shtonim dy gjëra, kontrata është tip dhe është e Mi nistirsë dhe mirë e tha zotëria, bashkohem me Kryetarin për sensibilitetin që duhet të marrim të ardhura, por ne kemi dhe diçka në dorë, që Administratorët e zonave respektive, në çdo fillim viti ose mund të caktojmë një kohë tjetër, të na bëjnë një listë të gatshme për interersin lokal që kanë fermerët dhe ne të kemi prioritet, që ata që janë të Podgories ti marrim ata, pse duhet të vijnë nga Velçani në Podogrie? Përveç këmbimit zonal.Dhe e dyta Kryetar, bashkë me ju ne të dy e dimë shumë mirë, që në datën 14.10.202, keni miratuar Planin e Përgjithëshëm Vendor dhe kur kemi folur dhe bashkë për detajimin të PlanitVendor në NJ.A, kemi një proces për të bërë.Ka gabime të mëdha në hedhjen në harografi, që kanë bërë Kompanitë Datec dhe AlbCONS, që Këshilli i parë i ka miratuar.Ka mirtaur toka pyjore dhe kullosore, në fakt toka që janë ZK, tokë arrë dhe kjo ka ardhur në këto zona ku flasim për kullota edhe për një arsye tjetër, kur Amerikanët bënë rregjistrimin thanë, më mirë të kemi harta të gabuara sesa të kemi harta në perefekson dhe mos kemi tokë në terren.Topografi që ken i ju në institucion që ka patur së paku zonën time në rregjsitrim fillestar, ata merrnin për çdo kartelë pasurie 100 lekë dhe këtë 100 lekshin e ndanin në 700 pasuri në fshatin Velçan dhe i çuan në Hipotekë dhe i inventarizuan dhe pastaj ky rregjsitrim fillestar, sidomos në zona ku flasim për kullota, nuk e ka përfunduar hedhjen e AMTP-ve të tokave bujëqsore dhe sjell konflikt midis meje, Kryetarit të Komisionit, Shefes të Urbanistikës dhe të tjerët.Meqenëse nuk ja dolën dota atje te unë ta shmangin si tokë bujëqsore, ju futën Lumit dhe ana tjetër e fshatit dhe është e dukshme, sepse Lumi nuk lëviz ka

vendi, pra të kemi parasysh, kemi marrë dhe atë zotërinë që është i Aseteve dhe Pronave, ju lutem para se të nënshkruajmë konteratat e kullotave, të kemi një transparancë që të paktën Dr e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, Dr e Aseteve dhe Drejoritë e tjera, të shprehen paraprakisht që në këtë zonë kur firmosen kontratat nuk ka konflikt interesi.dhe ti merret para firmosjes të çdo kontrate, ti merret aprovimi dhe NJ.A, sepse ne nuk i dimë si janë tokat e Zvezdës dhe ne ngremë kartonin për mundësitë që kemi.Ju faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit!Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mendoj që po flasim për dy gjëra të ndryshme edhe pse në momente të caktuara ndërlidhen me njëra tjetrën.Po flasim për kullotat, kullotat ne duam ti disiplinojmë me aktet ligjore në fuqi për fermerët tanë, nuk po flas që ne duhet ti mërzitim ata, por ti favorizojmë që ata të shtojnë blektorinë.Ajo që ngriti doktori, ne e kemi bërë, ne njoftojmë çdo fillim sezoni fermerët e zonës, Administratorët respketivë i lajmërojmë, sepse ata i njohin më mirë blektorët, por ata duhet ta kuptojnë që duhet të paguajnë dhe një kuotë.Në lidhje me Planin e Përgjithëshëm Vendor i cili mund të ketë dhe ndonjë gabim apo laspsus, Këshilli mund të marrë përsëri një vendim për ndryshuar apo për të rregulluar ndonjë mangësi që mund të ketë.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 10?

Kush është dakord ? 25 vota pro.
Kundra? 1 Almir Elezi
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 25 vota, Miratohet pika 10 faleminderit!Kalojmë te pika nr.11 e rendit të ditës, Këtu kemi tre familje, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Spiro Roko banues në bllokun nr.4 Maliq, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit"; Besnik Hysolli dhe z.ilir Ysolli banues në Korritë.Kemi ndonjë koment për këtë?
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Këto janë apgesa për efekt të rënies të zjarrit nuk janë ndihma financiare, ndoshta dhe në materail është hedhur gabim dhe dyta do i sygjeroja Këshillit, Sekretarit të Këshillit të vendosen vetëm inicialet, jo vetëm për këtë rast por dhe raste të tjera dhe mos vendosim emër mbiemër.
Yllson Ibrahimllari: Kryetar, shkelim ligjin, është e drejta e informimit dhe mbrojtja e privatsisë.Sekeratri ka bërë gabim ta korigjojë.

Pranvera Begolli: Me sa di është dhe një rast në F.Maliq, familja që i plasi Bombla e Gazit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kur të bëhet gati materiali do e sjellim.

Faslli Zholi: Unë jam plotësisht dakord, sepse ne për këtë jemi të jemi sa mëafër fatëkeqësive, doja të bëja një pyetje, a është bërë kjo për të tjera raste?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne e kemi detyrim ligjor, Sektori i Emergjencave Civile, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri, krijojnë një raport nga Komisiomi përkatës që del për çdo rënie zjarri me urdhrin tim, verifikon situatën në vend, merr informacion, ka një praktikë të gjerë për

këtë punë, ka një dosje për çdo rast, ne e kemi detyrim ligjor, për ta zbatuar dhe nuk lemë në asnjë rast famlije që mudn ti ketë rënë zjarri dhe mos e kemi trajtuar sipas përcaktimeve të VKM-së.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 11?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohen të tre rastet z.Spiro Rroko Mlaliq, Besnik Hysolli dhe z.ilir Ysolli banues në Korritë faleminderit!Kalojmë te pika nr.12 e rendit të ditës, P-V "Për dërgimin për bashkëfimincim të projektit *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizura"*për vitin 2025";Bashkangjitur keni listë, keni ndonjë diksutim lidhur me këtë pikë?
Petrit Kupe: Megjithë se nuk jemi anëtarë të këtij Komisoni, mendoj se këtu ka dy probleme, problemi më i rëndësishëm për mua është sepse bashkia po vazhdon që çdo vit të meremetojë çati për shumë familje të cilat janë në nevojë, por jemi realistë që shumë familje të varfra për shak të mungesës të dokumentacionit nuk po përfitojnë nga ky projekt dhe kjo për mendimin tim duhet sygjeruar në instancat përkatse, duke parë dhe kompetancat e Këshillit si mund të ndihmohen këto familje, gjithëkush e di për çdo fshat ka familje të tilla, të cilat nuk kanë as tapi as legalizim për banesat ku jetojnë dhe këto janë shtresa shumë të varfra.Si do zgjidhet? Ky është një shqetësim real se dhe komuniteti i shikon dhe thotë, pse dikujt i bëhet çatia dhe dikujt jo.Por nuk e di që ai nuk përfiton nga mungesa e dokumentacionit dhe diçka tjetër, këtë vit numri i banesave që përiftojnë është më i ulët nga vitet e kaluara, mendoj që se duhej bërë një punë më e mirë nga zyra përkatse për të ulumtuara gjithë aplikimet që kanë bërë familjet e tjera, që numri të ishte sa më i madh, sepse është një financim që bëhet në masën më të madhe nga qeveria dhe pjesën më të vogël nga bashkia.Këto dy gjera kisha për këtë P-V.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 12?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, Miratohet pika 12 e rendit të ditës, Kalojmë te pika nr.13 e rendit të ditës, Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë keshillit bashkiak *"Mbi heqjen e mandatit të znj.Rudina Bregu"*, pas kërkesës për dorëheqje.Te kjo pikë do ftoja znj.Rudina ti jepja fjalën.
Rudina Bregu:Përshëndetje të gjithve!I nderuar Kryetar i Bashkisë, të nderuar kolegë Këshiltarë, të nderuar qyetarë që na ndjkein.Dua tju falenderoj të gjithve, në vençanti elektoratin që më besoi dhe votoi që unë të isha pjesë e Këshillit Bashkiak Maliq, falenderoj Kryetarin e Bashkisë për besimin dhe vlersimin në këtë detyrë.Faleminderit!
Enida Avdolli: Faleminderit! I jap fajlën znj.Pranvera të lexojë raportin.

Pranvera Begolli:Përshëndetje kolegë!Ju dëgjuat fjalën e znj.Rudina që kërkon dorëhqjen dhe Komisoioni i Mandateve i mbledhur dje me datë 27.02.2028,Vendosi:

RAPORT (Heqje Mandati)

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Në zbatim ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015*"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, neni 49 *"Mandati i këshilltarit"* pika 2 dhe 5 gërma "b", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq*", neni 21 *"Mbarimi para kohe i mandatit të këshilltarit të bashkiak "* gërma "b" dhe të shkresës të znj.Rudina Bregu me lendë: *"Kërkesë për dorëheqje"* protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr.952 Prot, datë 21.02.2025 dokumeneti bashkangjitur.

1. Miratimin e raportit për heqjen e mandatit znj.Rudina Bregu, kanditate në listën shumemërore të Partia Socialiste e Shqipërisë pas krijmit të kushteve për mbarimin e mandatit para kohe të Këshilltarit Bashkiak.

2. Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për heqjen e mandatit dhe plotësimin e vakancës.

Raport i mbajtur sot më datë 27.02.2025 në Bashkinë Maliq, nga Komisioni i Mandateve Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare pranë Këshillit të Bashkisë Maliq, Ju faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim? Po.

Yllson Ibrahimllari:Për sa i përket Komisionit që drejton znj.Vera, në rastin konkret do ishte më normale sepse njerzit na ndjekin, ne miratojmë dorëhqjen e zonjës, ne nuk miratojmë heqjen e mandatit të zonjës e cila ka dhënë dorëhqjen, ne nuk heqim mandatin e dorëhequr, ne miratrojmë si Komsion si Këshill dorëhqjen. Faleminderit!

Pranvera Begolli: Ashtu e përmban rregullorja dhe unë zbatoj rregulloren.

Enida Avdolli: Faleminderit! E kalojmë në votim dorëheqjen nga mandati?

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24vota, Kalojmë te pika nr.14 e rendit të ditës, Informacion nga Zyra e Integrimit Europian dhe Koordinimit të Ndihmës të Huaj, lidhur me çështje të kërkuara nga Këshilli Bashkiak.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në mbledhjen e parë, patëm një kërkesë, veçanërisht për mjetin që do blemë me Ambasadën Japonezë, keni një informacion nga zyra përaktse.Paralelisht

me këtë zyra që merret me projketet ka dhënë dhe një informacion përmbledhës për gjithë projektet që ajo ka patur gjatë vitit 2024, për tu njohur Këshilli dhe për të bërë ndonjë sygjerim.

Lulëzim Hoxhaj: Nuk e di a janë në sallë këta të zyrës të integrimit?Unë e shoh me shumë rëndësi që të jepet ndonjë mendim lidhur me këtë inforamcion, së pari dua të them që çelja e negociatave me BE, ishte një sukes i madh për Shqipërinë dhe mendoj që këtu janë dy shtulla kryesore, shtylla e parë është empacimimi i shoqërisë, gjithë struktruave të saj, shtetit, për ta kuptuar mirë BE dhe çfarë kërkon BE për të empacipuar shoqërinë, shtylla e dytë është që BE për ta afruar Shqipërinë me BE jep donacione, unë dua ti them gjërat thjeshtë, së pari në të gjitha bashkiktë ka një strukturë të tillë, kam mendimin duke lexuar informacionin janë akoma në fushën Akademike dhe nuk janë në fushën konkrete, nuk e di a kanë kuptuar mirë detyrën që ata kanë dhe angazhimin që kanë marrë në lidhje me këtë zyrë.Unë mendoj që pasi lexova këtë informacion, dakord ka lëvizje, por e shoh pak më gjerë, këta duhet të përçojnë të parit, në komunitetin e bashkisë, në biznesin e bashkisë, çfarë kërkon dhe cilat janë orjentimet e BE për të investuar, unë di që në momentin që janë çelur negociatat me BE, BE ka akorduar 1 milardë Dollarë, këto 1 milardë Dollarë i përfitojnë strukurat qëndrore dhe bashkitë, të jemi të gatshëm për të përfitaur nga këto fonde ne duhet të paraqitemi me projekte dhe projkete dinjitoze, jam dakord me projektin me Ambasadën Japonezë ose për projektin për Fabrikën e Uthullës, për mua janë pak, kjo zjo zyrë e ka patur kohë, e kam si mesazh, duhet angazhim më i madh nag zyra, duhet të kenë njohuri se çfarë kërkon BE, për të dhënë këto fonde dhe dyta të përgjigjen kërkesave, dy orjentimet që jep BE, për fonde janë Agro-Turizimi dhe Bletaria, duke njohur këto prioritetet që ka BE ne duhet ti përgjigjemi, jam dakord që nuk do i bëjnë projektet 3 punonjësit e zyrës, por këtë duhet të nxitin biznesin e zonës , që ti bëjnë këto projekte.

Enida Avdolli: Faleminderit!Po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shqetësimi që u ngrit është shumë me vend, kjo zyrë është shumë e rëndësishme dhe kjo zyrë ka fulluar të rritet dhe po rritet nga njëri moment në tjetrin dhe kërkon vërtet njerës të aftë dhe që kanë një vizion, jo vetëm në hartim projektesh por edhe në aplikim.Aplikimi në fondet e BE është një risi më vete, gjatë këtij viti ne kemi aplikaur në shtatë projekte dhe jemi shpallur fitues në tre në fazën e parë dhe shpresojmë që do finalizohen.Një projket me Maqedoninë, për të cilin ka ardhur grupi e kemi shpallur ndërhyrjen në kanlin Reka në Drithas, një projekt i dytë me Greqinë ku ne jemi partnerë dhe një tjetër me Hungarinë, ku jemi partnerë, për një projekt që ka të bëjë me mjedisin, për katër projektet e tjera jemi në pritje, të shpresojmë që do fitojmë dhe ato.Por çka kemi arritur në vitin 2024, nuk e kemi arritur në vitet më parë, ku eksperienca e zyrës nuk ka qenë nivelin e duhur dhe ne presim dhe zygjerimt tuaja këtu.

Enida Avdolli: Faleminderit!Po.

Yllson Ibrahimllari:I kam kërkuar Kryetarit inforamcion më të zgjeruar për ndihmën Japoneze për zonat Rurale, e lemë për mbledhjen tjetër nuk ka problem.Për mjetin e ka kërkuar z.Hoxhaj, unë kam kërkuar çfarë përmbledh në vetë vetë ndërhyrja në rrugët Rruale që keni në marrveshje me Ambasadën Japoneze?Duke qenë këtë kuadër, unë besoj që dhe Këshilltarët e kanë këtë të drejtë të paraqisin projekte dhe të aplikojnë, një projekt kam nisur unë me një fondacion Suedes, do ja paraqes dhe Administarorit të Moglicës dhe të Gorës, atje ku ka shpyllësim të madh të bëhet dhe mbjellja.Faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit!Kemi dy P-V shtesë, të ardhura nga Drejtoria e Shërbimit Social.Një P-V për shpenzime varrimi dhe P-V tjetër Mbi miratimin e marrëveshjes e bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të qarkut Korcë, "Qender ditore për të moshuarit" ashtu si u informuam në fillim kur miatuam rendin e ditës.Kemi ndonjë diskutim për këto dy P-V? Janë diskutuar dhe në Komision.

Floreta Zaçe: Kam rastin e një familje në fshatin Plasë, e cila ka humbur vajzën e tij dhe ti japim një ndihmë për shpenzimet e varrimit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të shikohet rasti nga Drejtoria, ju shumë mirë që ngrini shqetësime, tja paraqesim Drejtorisë të Shërbimit Social dhe bazuar në VKB-në që kemi marrë për këto raste, të shihet si rast dhe unë nuk do kisha asnjë kundërshtim.

Yllson Ibrahimllari: Rasti ne zonjës ne e kalojmë në votim në parim, nëse i përmbush kriteret le të quhet e votuar. Faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit!Kemi P-V për shpenzime varrimi, duke përfshirë dhe rastin e zonjës.

E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota, P-V tjetër Mbi miratimin e marrëveshjes e bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të qarkut Korcë, "Qender ditore për të moshuarit"

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota.Me këto dy P-V mbyllen pika e rendit të ditës.Te diskutime të tjera kemi diçka?

Almir Elezi: Pas ndërtimit të ujsjellsit në fshatin Podgorie, rrugët e fshatit janë dëmtuar shumë, ka mundësi ti riparojnë përsëri me asfalt?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Projketi po realizohet nga Agjencia e Kombëtare Ujësjllës Kanalizime, jo nga bashkia Maliq të cilët dua ti falenderoj është një investim shumë i madh dhe patjetër të gjitha rrugët do kthehen në gjendjen e më parshme, madje më të mira, të gjitha ato që kanë qenë me asfalt do kthehen me asfalt, atje ku janë me çakull do kthehen me çakull.Me ngrojen e motit do fillojnë punët.

Faslli Zholli: Kam diçka këtu, në fshatin Podgorie, në lagjen Gorevecët ka mungesë ndriçimi dhe pagujanë ndriçimin dhe një që më shqetëson ndirçimi është shumë i dobët 120 volt.Se dyti dua të di se çfarë u bë me lagjen në fshatin Korritë për ndiriçimin, kam kërkuar që Barka e shëndetësisë të bashkohet në Libonik dhe atje te rruga ku banoj unë është dëmtuar shumë nga Ujësjellsi, për sa i përket Sheqerasit rruga deri te vorrezat është shumë e dëmtuar të shikohet, doja të ngrija dhe një shqetësim tjetër, është një person i vetmuar në Sheqeras, është dhe i sëmurë, të shikohet për ndonjë ndihmë, z.Sazan Hoxha dhe shqetësimin për z.Ramzan në Drithas Poshtë, do bëhet apo jo.

Petrit Kupe: Kam dy problme me fushën e Drithasit, është momenti që fillon shtrimi i rrugeve të fushës, mjetet janë duhet bërë, tjetër është bërë pastrrimi i kanaleve por janë thelluar shumë, uji që është aq apk nuk do shërbejë për vaditje me një filtrim, për të eleminuar këtë duhet të vendosen prita.

Enida Avdolli: Faleminderit!Kemi diçka tjetër?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në lidhje me ndriçimin, lagjen Gorevec ne e kemi ndriçuar, mund të ketë probleme të vogla, atje ku ak mungesë shtyllas, do verifikoj në terren, në lidhje me tensionin në fshatin Podgorie që është i ultët, dua të informoj Këshillin dhe qyetatarët, që sot ka ardhur projekti për kthimin me ABC të tetë fshatrave të Bashkisë Maliq, midis tyre dhe Podgoria, Pirgu, Drithas, Shqitas etj, do bëhet rrjeti i ri dhe me kabina të reja, nuk do ketë defekte dhe do ketë tension më të alrtë, në lidhje me Bregasin kemi futur pojektin nga fshati në drejtim të shkollës, cili do jetë dhe me ndriçim.Në lidhje me Qendrën Shëndetësore Libonik, unë kam dhënë një porosi për bashkim, atje kemi një ngërç.Kalnali i ujrave të bardha në Libonik do të sitemohet e kam dhënë porosi të sitsemohet, në Sheqeras rruga e varrezave do bëhet me asfalt, por jo vetëm kjo dhe rrugë të tjera që të çojnë në varreza, për shtëpinë në Sheqeras duhet ta ndjekë Ledioni, ne ju paguajmë qiranë e shtëpisë, le të gjejnë shtëpi që janë të lira, ne nuk kemi banesa sociale, kjo është një zgjidhje.Në lidhje lidhje me sheqetësimet që ngriti Petriti, fusha e Drithasit do ketë radhën për efekt të çakëllimit të disa rrugve kryesore të parcelave, por edhe në fshatra të tjerë, kemi parshikuar dhe në buzhet dy fonde, njërin për blerje çakulli vetëm për transport, spepse çakullin e e kemi vetë, kjo e thellimt të kanalve duhet parë.Paralelisht me këtë po realiozjmë një projket për betonimin e një kanali nga Podgoria të fushës dhe një kanal tjetër nga ura e Lumalasit në drejtim të Vashtëmisë.Shumë falminderit!

Nersida Shindo:Në Vloçisht i kanë kërkuar nga 300 lekë nxënsve, për të bërë piktura për fëmijët me Autizëm.Dua të di a ka bashkia Piktor?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do e verifkoj dhe do ta dërgoj Piktorin e Bashkisë.

Enida Avdolli: Faleminderit! I Japim fjalën Doktorit.

Yllson Ibrahimllari:E nderuar nënkryetare, rubrikën e diskutimeve ta ndajmë në dy pjesë, të paraqsim problemet por të kthjemë dhe përgjigj është rasti i znj.Vera nga mbledhja e kaluar, që kishte zonjën e paralizuar, nuk kemi informacion, e dytja është problemi i që ngriti Faslliu për çatinë që kishte ngërç ligjor, shikoj një shqetësim të banorve për mungesën e koshave të mbeturinave dhe ndriçimit, bizneset i paguajnë taksat, duhet të jemi pak të ndjeshëm me bizneset, duhet të marrin shërbimin.Kam dhe një sygjerim Kryetar, fusha e Korçës i plotëson kriteret për të qen ëunazë, nuk do ishte mirë për një linjë transporit publik, të fillojë nga lapidari i Podgories dhe do bënte zgjidhje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne jemi të hapur, kush është i gatshëm ta marrë, ja japim si linjë.

Yllson Ibrahimllari: Faleminderit!

Enida Avdolli: Faleminderit! Kemi një qytatar.Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Problemi i është zgjidhur qytatarit.

Qytetari: Ju falenderoj për miratimin e fondit për banesat sociale, fondet e kempit janë ndërperë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Fondet nuk janë kompetencë e bashkisë.

Lulëzim Hoxhaj:Kullimi nuk bëhet në dimër por në verë, nuk ishte realizuar fondi.

Enida Avdolli: Faleminderit! Kjo ishte mbledhja!

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI